

URDHËR
Nr. 372/1, datë 8.7.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 372, DATË 11.6.2021, TË MINISTRIT TË DREJTËSISË, PËR ZBATIMIN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19 NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE DHE INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; nenit 9, të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”; nenit 5, pika 6, të ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”; pikës 5, të urdhrit nr. 372, datë 11.6.2021, të ministrit të Drejtësisë, “Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, përcjellë me shkresën nr. 7125 prot., datë 5.7.2021,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 372, datë 11.6.2021, të ministrit të Drejtësisë, “Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, germa “P”, togfjalëshi “në jo më shumë se 2 (dy) persona”, zëvendësohet me “në jo më shumë se 2 (dy) persona të rritur dhe 2 (dy) persona të mitur”.

2. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për njoftimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohen drejtori i përgjithshëm i Burgjeve, Sektori i Shëndetësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe drejtuesit e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale për zbatimin e këtij urdhri. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)